



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2419, datë 06.02.2014

Për

“Miratimin e Dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | | | |
|----|------|--------|------------|---------|
| 1. | Z. | Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. | Z. | Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. | Znj. | Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. | Z. | Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. | Znj. | Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj , në mbledhjen e datës 06. 02. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar”

BAZA LIGJORE:

1. Kodi i Procedurës Administrative (*Kpra*);
2. Shkronja p) e nenit 8, nenet 87, 88 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;
3. Rregullore Nr. 13, datë 16.04.2010 për “ Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010 (*Rregullore*), e ndryshuar;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi Projektaktin : “Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, ndryshuar me VKD nr. 1530, dt. 18.3.2011, ndryshuar me VKD nr. 1776, dt 20.2.2012”;
2. Dokumenti për këshillim publik;
3. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar; si dhe,
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Grupi i punës i ngritur sipas Urdhërit nr. 1098, datë 28. 01. 2014 me qëllim: “Hartimin e një dokumenti për këshillim publik **“Për disa shtesa dhe ndryshime në në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar”**, në funksion të zgjidhjes së disa problemeve që janë evidentuar gjatë ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues, Dokumentin për Këshillim Publik “ Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar””.
2. Duke marrë në konsideratë çështjet e diskutuara me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në takimet e kryera nga AKEP-i që nga marsi 2013 e deri në takimin e fundit më datë 28. 08. 2013 me operatorët e telefonisë fikse dhe të lëvizshme, konkluzionet e arritura në këto takime, si dhe shkresat e dërguara në AKEP nga këta sipërmarrës, evidentohen disa probleme shqetësuese lidhur me zbatimin e tij, që çojnë në rritjen e numrit të mospranimit të kërkesave për bartje si;
 - Rritja e numrit të pajtimtareve postpaid të cilët nuk përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale mbi shlyerjen e detyrimeve për shërbimin e marrë nga operatorët, dhe bartin numrin në një rrjet tjetër pa shlyer detyrimet,
 - Shtimi i rasteve të kërkesave për anulim pas dorëzimit të kërkeses për bartje, etj.
3. Për zgjidhjen e problemeve të evidentuara, nga pikëpamja rregullatore rekomandohen disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar.
Ndërhyrja në rregullore do të shërbejë për uljen e numrit të refuzimeve të kërkesave për bartjen e numrit nga ana e të gjithë sipërmarrësve të autorizuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të telefonisë së lëvizshme dhe fikse.

4. Ndërhyrjet e propozuara në Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, meqenëse përbëjnë një dokument rregullator me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, rekomandohet marrja dhe vlerësimi i mendimit të palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.
5. Nga pikpamja thelbësore propozimi është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
6. Ndërhyrja në Rregullore i shërben qëllimit të përmirësimit të kuadrit rregullator për ofrimin e shërbimit të Portabilitetit të Numrit dhe eliminimit të problemeve të evidentuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, për sipërmarrësit dhe pajtimtarët, bazuar në germen p) të nenit 8, neni 87, 88, 110 , 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar;

V E N D O S:

1. Të miratojë për Këshillim Publik dokumentin rregullator “Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në internet në faqen zyrtare të AKEP;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

DOKUMENTI PËR KËSHILLIM PUBLIK

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”, e ndryshuar”.

AKEP, nisur nga disa probleme të ndeshura kohët e fundit lidhur me procesin e bartjes së numrit gjykon se është koha për të bërë disa ndryshime në Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për të gjitha palët e interesuara.

1. AKEP vëren se një nga çështjet më të rëndësishme për të cilat duhet rishikuar rregullorja është ajo që ka të bëjë me qëndrimin që duhet mbajtur ndaj kërkesës për bartje nga pajtimtarë me detyrime të pashlyera kundrejt operatorit dhënës. Lidhur me këtë AKEP propozon që Neni 5, Të drejtat dhe detyrimet e operatorit dhënës, pika 5 të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar,

“Operatori dhënës është i detyruar të eksportojë numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Nëse një numër është çaktivizuar vetëm përkohësisht (p.sh. sipas sanksioneve të kontratës për mos pagesë), operatori dhënës është përsëri i detyruar të eksportojë numrin”

Të dryshojë dhe të bëhet:

“Operatori dhënës është i detyruar të eksportojë numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Në rastet kur pajtimtari ka detyrime të pashlyera sipas përcaktimeve në dokumentin “Rregulla për “Termet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtari për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike””, miratuar me VKD nr. 2405, datë 26.12.2013, atëherë operatori dhënës është i detyruar të pranojë kërkesën për bartje por bartja do të ekzekutohet vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimet.”

Pyetje: A jeni të njëjtit mendim me AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

2. AKEP mendon se duhet vendosur një **kohë minimale e detyrueshme** për kërkesin e bartjes që të qëndrojë për të paktën 3 muaj në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje. Kështu në Kapitullin II, Të drejtat dhe detyrimet në kontekst të portabilitetit të numrit,

Neni 4, pika 5, Të drejtat dhe detyrimet e pajtimitarit, të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, "Për Portabilitetin e Numrit", miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar:

Kontrata mes pajtimitarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimitari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimitari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë.

Të ndryshojë dhe të bëhet:

*Kontrata mes pajtimitarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimitari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimitari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë. **Koha minimale e detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje është 3 muaj.***

Pyetje: A jeni dakort me propozimin e AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

3. AKEP vëren se në disa raste operatorët kanë refuzuar kërkesat për bartje duke shfrytëzuar dhe keqinterpretuar përmbajtjen e nenit 15, Përgjigja për bartje pika 2), gërma c) paragrafi

aa) - *kërkesa për bartje nuk mund të lexohet ose ka ndonjë gabim tjetër lidhur me specifikimet teknike të kërkesës për bartje;*

të Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010, "Për Portabilitetin e Numrit", miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010, e ndryshuar.

AKEP propozon që **ky paragraf të hiqet** dhe të ndryshojë gërmëzimi i paragrafit, bb) të bëhet aa) e kështu me rradhë. Me këtë ndryshim përmbajtja e paragrafit:

Operatori dhënës nuk do të dërgojë përgjigje negative për asnjë arsye tjetër përveç këtyre gjashtë arsyeve të përmendura më sipër.

bëhet:

Operatori dhënës nuk do të dërgojë përgjigje negative për asnjë arsye tjetër përveç këtyre pesë arsyeve të përmendura më sipër.

Pyetje: A jeni dakort me propozimin e AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

4. Shtojca formular i “Kërkesë për bartjen e numrave” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010 dhe ndryshuar me Vendimin nr.1530 datë 18.03. 2011 të jete sipas lidhjes bashkengjitur.

AKEP-i fton të gjithë operatorët të përgjigjen këtij këshillimi.

Shtojca
Kërkesa për bartjen e numrit

| |
|---|
| Numri i telefonit që do të bartet: |
| Emri i pajtimtarit: |
| ID (nëse pajtimtari është individ): |
| Numri NIPT (nëse pajtimtari është i regjistruar): |
| Numri i telefonit do të bartet nga rrjeti i (“operatori dhënës”): |
| Numri i telefonit do të bartet në rrjetin e (“operatori marrës”): |
| Data kur do të bëhet bartja: <input type="checkbox"/> brenda 3 ditëve pune ose <input type="checkbox"/> ____ . ____ . ____ data, muaji, viti |

Unë, i nënshkruari, jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri të telefonit do të thotë që numri i plotë (duke përfshirë edhe tri shifrat e para) transferohet nga rrejtja e një operatori (“operatori dhënës”) në rrjetin e një operatori tjetër (“operatori marrës”). Si pajtimtar i një shërbimi telefonik kam të drejtën të kërkoj bartjen dhe që të dy, operatori i vjetër dhe i ri janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Pajtimtari kërkon bartjen nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti dhe paraqitjes së tij tek operatori marrës, i cili duhet ti ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin.
- b) Kontrata ime ekzistuese me operatorin dhënës do të përfundojë në kohën kur bartja bëhet efektive, por bartja nuk do të përfundojë detyrimet ekzistuese kontraktore.
- c) Në veçanti, unë duhet ti paguaj operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara që dalin nga kontrata ime ekzistuese. Kjo mund të përfshijë tarifën për portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin nëse unë e anuloj kontratën para kohëzgjatjes minimale të kontratës të rënë dakord.
- d) Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj operatorit dhënës, këto çështje duhet ti sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin dhënës para nënshkrimit të këtij dokumenti.
- e) Operatori marrës është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet ti paguaj operatorit marrës dhe nëse unë mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e operatorit marrës.
- f) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifën e kontratës së re, do ti sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin marrës para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra”numer.
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin marrës sipas kushteve kontraktore, kushteve dhe tarifave të përgjithshme të biznesit të cilat më janë paraqitur nga operatori marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin e përmendur nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e operatorit marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit dhënës për anulimin e kontratës time ekzistuese për numrin e përmendur.

(Vendi dhe data)

(Nënshkrimi)